

Hapet konkursi për punëtorinë dyditore të poezisë, që do të mbahet në Tetovë

# Poetët e rinj shqiptarë ftohen të njihen me "poetry slam"

PRISHTINË, 14 NËNTOR — Të rinj nga Prishtina, Shkupi dhe Tetova, të cilët pëlqejnë artin e të shkruarit, do të bëhen bashkë për dy ditë në fillim të muajit dhjetor. Nën drejtimin e Michel Abdollahit nga Hamburgu ata do të shkruajnë poezi dhe tregime të shkurtër, "poetry slam", në punëtorinë që nis në ditën e dytë të dhjetorit në Tetovë. Punëtorja dyditore organizohet nga qendra për bashkëpunim ballkamik "Loja" nga Tetova, "Kontrapunkt", nga Shkupi dhe qendra "Multimedia" nga Prishtina. Konkursi për të gjithë ata që kanë mbi 18 vjet, kanë talent për të shkruar poezi e në të njëjtën kohë duan që mendimet e tyre t'i ndajnë me të rinj tjerë në grup, tashmë është i hapur.


Në një komunikatë për shtyp të lëshuar nga qendra kulturore "Multimedia", thuhet se evenimenti final, që përfshin performimin e

vërtetë do të mbahet në mbremjen e tretë.

"Një nga një, çdo poet do të performojë për 5-10 minuta me tekstin e tij/saj, pa marrë parasysh ka përvojë apo jo në këtë lëmi, ose është person i turpshëm apo i hapur", thuhet në komunikatë.

"Poezitë e shkruara dhe tregimet e shkurtër do të lexohen apo recitohen në skenë dhe do të gjykojnë nga audienca. Juria e zgjedhur nga audienca do të votojë për poezinë e tyre të preferuar", vazhdon më tej komunikata.

Kultura e Poetry Slam është zhvilluar në fundvitet e 80-ta në Çikago, por shpejt është përhapur edhe në Evropë. Sot konsiderohet si formë e shumë njohur e kulturës bashkëkohore. Gjermano-iramiani Michel Abdollahi, i lindur në vitin 1981 në Teheran, ka themeluar skenën "Poetry Slam" në Hamburg. Gjithnjë, sipas komu-



nikatës për shtyp, ai ka eksperimentuar në mbajtjen e punëtorive dhe kurseve të tilla.

"Shkëmbimet ndërkulturore dhe ndërreligjioze janë ndër esenciale të këtij programi. Jo vetëm shkak i origjinës së tij dhe dialogut mes Lindjes dhe Perëndimit që është

shumë i rëndësishëm për të, por ai kupton artin dhe gjuhën si një lidhje mes tij dhe audiencës së tij", vazhdon komunikata.

Gjuha në të cilën do të punojnë poetët e rinj do të jetë ajo amtare, ndërsa përkthimi do të bëhet gjatë punëtorisë.